


TRIBUNA SINDIKALE

Dhjetor 2005

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë



Editorial

2006 - SYNIME DHE OBJEKTIVA KONKRETE

Nga Xhafer Dobrushki
Kryetar i FSASH

Viti 2006 po afrohet. Po mbyllet një vit me sfida e ballafaqime të vështira, vit që i vuri sindikatat e arsimit para provave serioze, por edhe i pergatiti për të ndërmarrë hapa të rinj me të guximshëm, për të synuar për një punë e veprimitari me cilësore në të gjitha strukturat sindikale dhe për të percaktuar objektiva konkrete për 12 muajt e ardhshëm.

Cilat janë disa nga këto synime dhe objektiva që FSASH dhe SPASH synojnë të arrijnë për vitin 2006 ?

Negocimi dhe nënshkrimi i Kontrates së re Kolektive të Punes për vitet 2006-2008.

Nga të dy sindikatat janë bërë përgatitjet e dhura për të filluar që në ditët e para të vitit të ri diskutimin me hollesi, nën për nën, të Kontrates ekzistuese dhe për të bërë plotësimet, përmirësimet, shtesat dhe ndryshimet e nevojshme në Kontraten e re. Për këtë është deklaruar i gatshëm edhe punëdhënësi, Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Po çfarë synohet të përmirësohet apo ndryshohet në Kontraten e re Kolektive?

Se pari, do të konkretizohen me mirë kushtet e punësimit, përfshirë punësimin, transferimin, largimin nga puna apo uljen në detyrë të mesuesve të të gjitha kategorive, punonjësve dhe drejtuesve të shkollave për t'i përshtatur me mirë dispozitat perkatëse të Kontrates Kolektive me standardet bashkëkohore, me kërkesat e Konventave Ndërkombëtare të Punes dhe me gjithë kuadrin ligjor shqiptar të marrëdhënieve të punës.

Se dyti, Kontrata e re Kolektive, për pesëditjet me thellesore, sic janë punësimi, kushtet e punës, lirite dhe të drejtat sindikale, etj. do t'i shprehë efektet në të gjitha kategoritë e të punësuarve në sistemin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, duke filluar nga arsimit parashkollor deri të arsimit të lartë dhe punonjësit ndihmes.

Se treti, në Kontraten e re Kolektive do të saktësohen me mirë dhe do të përfshihen norma të reja lidhur me pagat dhe motivimin e mesuesve. Në këtë kuader, Sindikatat e Arsimit do të përfshihen me me përgjegjësi dhe me efektivitet në luftën kundër korrupsionit në arsim.

Si partnerë ligjorë të punëdhënësit, ato do të luftojnë kundër shpërdorimit të fondeve, fenomen që deri me sot ka qenë shqetsues. Në Kontrate do të percaktohen norma dhe

kritere të sakta për motivimin e mesuesve, sidomos për ato zgjidhje të dëritshme që janë bërë ekskluzivisht me inisiativën dhe veprimet e sindikatave, sic janë shpërblyerit që lidhen me pagën e 13-të, shpërblyerit deri në dy paga

për ata që dalin në pension dhe çdo shpërblyer tjetër, të cilat nuk do të jete me të barabarta, por do të percaktohen nga punëdhënësi, në bashkëpunim dhe me autorizim të sindikatave, sipas kontributit në punë, sipas cilësive se punës se kryer nga secili.

Se katërti, një vend të veçantë do të zënë në kontrate angazhimi i sindikatave të arsimit në problemet dhe çështjet që lidhen me thellimin dhe zbatimin e reformës në arsim, për modernizimin e arsimit, për një arsim cilësor publik dhe për të mesuarit gjatë gjithë jetës, sic janë kualifikimi i mesuesve, angazhimi për një punë me cilësore në nxënësit, tërheqja e nxënësve dhe studenteve në bashkëpunimin me sindikatat, angazhimi në veprimtari konkrete me nxënësit që braktisin shkollën, me nxënësit që punojnë në mënyrë të paligjshme, që përfshihen në veprimtari kriminale deri të trafikimit të tyre etj.

Se pesti, në Kontraten e re Kolektive të Punes do të pasqyrohen me saktë marrëdhëniet dypalëshe me pushtetin vendor, përfshirë keshillat e qarqeve, prefekturat, bashkitë dhe komunat si dhe me drejtoritë arsimore rajonale apo zyrtar arsimore.

Objektiv me rëndësi do të jete përgatitja e draftit dhe miratimi i Statusit të Mesuesit.

Në muajt e parë të vitit të ri, të dy palët, si sindikatat ashtu edhe MASH, do të intensifikojnë punën që kanë nisur për të konkretizuar një projekt të Statusit të Mesuesit.

Miratimi i këtij Statusi, si një dokument ligjor, i përshtatur me Strategjinë e Arsimit, me Konventat Ndërkombëtare të Punes dhe ligjet e shtetit tonë, do të jete një garanci për çdo mesues, se personaliteti i tij do të mbrohet, se puna e tij do të mbrohet drejt dhe do të motivohet, se lirite e të drejtat e tij do të jete të paprekshme, se ata nuk do të jete me pre e subjektivizimit, padrejtësi, hakmarrjes, etj.

Fugizimi i Sindikatave të Arsimit përben dhe do të perbejë një objektivi parësor të tyre.

Tashme të dy sindikatat e arsimit në Shqipëri nuk janë në atë nivel që ishin dhjetë ose edhe pesë vjet më parë. Funksionimi i tyre mbështetet me fuqishëm në strukturat statutoare që kanë ndërtuar dhe në përvojën që kanë fituar si anëtarë me të drejtë të plota të Federatës Botërore të Arsimit, EI.

Por, në këtë stad, nisma që ato kanë ndërmarrë me mbështetjen e Federatës Botërore të Arsimit, EI, dhe të Sindikatës Holandeze të Arsimit, AOB, për fuqizimin e sindikatave të arsimit, marr një kuptim dhe rëndësi të veçantë.

Sindikatat e Arsimit, SPASH dhe FSASH, janë të vendura që të përballen me këto objektiva gjatë vitit 2006 dhe t'i arrijnë ato.

PERMBAJTJA

✓ Editorial:	
2006, synime dhe objektiva konkrete	2
✓ Çfare na mesoi viti 2005? U zhvillua Kongresi i Katert i SPASH	3 4
✓ Arsimit parashkollor, baza e sistemit arsimor	6
✓ Trajnime dhe plane veprimi konkrete për parandalimin e punës së femijeve	7
✓ Pervoje nga Shkolla 9 - Vjeçare "Dino Ismaili", Levan, Fier	9
✓ Duhet të sigurojme që Rezolutat të peruthen me veprimet	11
✓ Bashkëpunim i frytshëm i keshillit sindikal me drejtorinë nga Murat Gecaj	13
✓ Te reja shkencore dhe keshilla praktike, nga Eriona Vangjeli	15

Kopertina e parë:

Çast nga bisedimet me MASH në lidhje me kërkesat e FSASH dhe SPASH

Kopertina e fundit:

Interesimi i medias gjatë bisedimeve të FSASH dhe SPASH në MASH

TRIBUNA SINDIKALE

Nr. 17, Periodike

Botim i FSASH dhe SPASH
ADRESA: Bulevardi "Zogu i Parë"
Pallati Ali Kelmendi, kati III,

Tel: 22 83 46

Tel & Fax: 25 65 32

Keshilli Botues:

Xhafer Dobrushki,

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor

ÇFARE NA MESOI VITI 2005?

Tani që po kalojnë ditët e fundit të këtij viti dhe ndërsa presim për të festuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri, nuk mund të mos i hedhim një sy ngjarjeve që dy sindikatat tona të arsimit përjetuan dhe përballuan në 2005-n.

Nuk mund të thuhet se ky ishte një vit i qetë. Ai filloi me levizje sindikale, me përballje me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Qeverinë për rritjen e pagave për vitin 2005 dhe vazhduan për disa kohë diskutimet ose pakëngesite për rritjen e pagave për vitin 2004. Në këtë vit duhej të perfundonte negociimi dhe nënshkrimi i Kontrates së re Kolektive të Punës dhe projekt-drafti për Statusin e Mesuesit.

Nuk mund të thuhet se sindikatat e arsimit i anashkaluan këto përballje ose u tërhoqën para veshtiresive me të cilat u ndëshan.

Ishin grevat e zhvilluara në muajin dhjetor 2004 ato që bene të mundur që pagat e mesuesve për këtë vit të rriteshin në masën 11.4 përqind. Por sindikatat e arsimit, si të gjithë sindikatat e profesioneve të tjera në Shqipëri, të vëna para faktit të kryer për buxhetin e vitit 2005, të cilin e moren me shumë vonese nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, për pasojë filluan me vonese negociimin për këtë projekt buxhet dhe në një farë mënyre u gjeten të papërgatitura. Kjo i vuri në veshtiresi edhe në saktësimin e synimeve për rritjen e pagave për këtë vit dhe vecanrisht në harmonizimin e dialogut në tavolinë me levizjen sindikale.

Paralajmërimi i sindikatave për grevë në fillim të prillit çoi në nënshkrimin e Mar-

reveshjes së njëdhur të 11 prillit për rritjen e pagave 15 përqind, duke filluar nga 1 shtatori. Por pavaresisht situatës së vecante që krijoi fillimi i fushatës zgjedhore, këmbëngulja në kohë për zbatimin e kesaj Marreveshjeje duhej të ishte me e madhe. Tani të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se sa përparësi u dëshan nga sindikatat për të riparuar mos



zbatimin e kesaj marreveshjeje, dhe për të arritur që mesuesit të marrin të pakten shpërblyerim shpërblyerim përkatës. Ky rast përben një mesim të madh për sindikatat e arsimit në kuptimin që ato se pari, nuk duhet të vonohen në levizjet sindikale dhe se dyti çdo negociim ose marreveshje duhet të shpërblyerim me aktet përkatëse ligjore detyruese.

Fenomeni i venies së sindikatave para faktit të kryer do të ishte përsëritur edhe këtë vit, nëse nuk do të nxirreshin konkluzionet e duhura nga përvoja e vitit të kaluar dhe nëse nuk do të bëhej i mundur kontaktimi i përfaqësuesve sindikaliste me nivelin më të lartë të punëdhënësve.

Tipike është periudha shtatori - dhjetor e këtij viti, kur

Këshilli Drejtues i FSASH, i ndodhur para faktit të moszbatimit të Marreveshjes së 11 Prillit nga Qeveria e mëparshme, nuk u tërhoq nga lufta sindikale, diti të orientohet në kushtet e reja dhe në dy mbledhje të një pasnjeshme, përpunoi me realizim kërkesa të qarta për Qeverinë e re, shpalli përshkallëzimin e luftës sindikale në

fitonin terren dhe eperi argumentet bindëse për drejtësinë e kërkesave që paraqiten sindikatat.

Kjo luftë sindikale e vendosur dhe e qarte çoi në Marreveshjen e ditëve të fundit midis Ministrisë Pollo dhe përfaqësuesve të FSASH e SPASH, sipas së cilës mesuesit e sistemit

Parauniversitar të përfitojnë për këtë vit, përveç pages së 13-të edhe një shpërblyerim të dytë, të barabartë me mesatarisht 50 përqind të një page mujore neto, si kompensim të asaj që mesuesit do të përfitonin sipas Marreveshjes së 11 Prillit, për periudhën shtatori - dhjetor.

Po kështu, u arrit që, për vitin 2006, pagat të rriten në masën 20 përqind duke filluar nga muaji prill, gjë që nuk është arritur gjatë ketyre 7-8 viteve të fundit, me përjashtim të vitit 1999, kur u zhvillua një grevë njëjavore.

Në vitin 2005 të dy sindikatat e arsimit vazhduan me sukses zbatimin e programit të ndërtuar me asistencën e Sindikates Holandeze të Arsimit, AOB, për fuqizimin e sindikatave. Ky program do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2006. Duke marrë shkas nga arritjet e vitit që po mbyllem, SPASH e FSASH, kanë tërhequr vëmendjen që tani, për thellimin e ketyre veprimtarive dhe vecanrisht për matjen e rezultateve të atyre objektivave që kemi caktuar bashkërisht.

E rëndësishme është që FSASH dhe SPASH janë të vendosura që t'i analizojnë dobësitë dhe veshtiresitë me të cilat u ndëshan gjatë vitit 2005 dhe të nxjerrin mesime për të përmirësuar punën e tyre në muajt e vitet që vijne.

U zhvillua Kongresi i IV i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, SPASH

Z. Bajram Kruja u rizgjedh në krye të SPASH edhe për një mandat tjetër
- Ministri Pollo, nuk dërgoi asnjë përfaqësues të tij në Kongres, me gjithë ftesat e bëra nga SPASH si partnere sociale dhe nënshkruese e kontratës kolektive të punës

Nga Spiro NAKUÇI

Analiza e punës dhe veprimtarisë mes dy kongreseve zgjedhore, miratimi i ndryshimeve në Statutin e SPASH, zgjedhjet e reja për forumet e larta dhe organet e tjera staturore si dhe zgjedhja e Kryetarit të kësaj sindikate, ishin pikat kryesore të rendit të ditës të Kongresit të IV të SPASH, i cili i zhvilloi punimet e tij në mjediset e hotel "Florida" në Durrës, më 27 nëntor .2005.

Ishin të ftuar, të pranishëm dhe përshëndetën punimet e këtij Kongresi: Presidenti i BSPSH-së Gëzim Kalaja, kryetari

të BSP-ve të BSPSH-së. Kryetari i SPASH, z.Bajram Kruja, për shkak të gjëndjes së tij shëndetësore, nuk mori pjesë në punimet e këtij Kongresi.

Respekti për të hapur punimet e këtij Kongresi i takoi Hysen Dajës, mësues i vjetër dhe kryetar i SPPSH-së. Dëfrim Shahu, nënkryetari i SPASH, vijoi më pas me komunikimin e rendit të ditës dhe miratimin e procedurave të Kongresit.

Raportin e analizës së punës dhe veprimtarisë së kësaj sindikate për periudhën midis dy Kongreseve, e mbajti Aleks Dushi. Në raportin e tij, Dushi bëri një historik të të gjithë aktivitetit të SPASH,

mangësitë dhe mungët për të përmirësuar punën, ishin objekt i raportit, në të cilin parashikoheshin edhe ndryshime staturore në kuadrin e aderimit në BSPSH.

Në vijim të Kongresit përshëndeti delegatët Presidenti i BSPSH-së Gëzim Kalaja. Ai vlerësoi lart pjesëmarrjen në këtë Kongres të delegacionit të SBASHK të kryesuar nga Ali Shabani, prezencën e drejtuesve të lartë të Sindikatave të profesioneve të BSPSH-së, të përfaqësuesit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, drejtorit të marrëdhënieve profesionale në këtë ministri Gjergji Muça; prezencën e kryetarit të FSASH Xhafer Dobrushit etj. Kalaja e konsideroi privilegj pjesëmarrjen e tij në këtë kongres dhe në vijim të fjalës së tij, trajtoi disa probleme të lëvizjes sindikaliste të BSPSH-së e të fushatës zgjedhore në të gjitha strukturat e saj.

Kongresin e përshëndeti, më pas, kryetari i SBASHK-së Ali Shabani. Në fjalën e tij, Shabani vlerësoi lart bashkëpunimin me SPASH në të gjitha fushat me interes reciprok si dhe vuri në dukje se edhe në të ardhmen me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës së Kosovës SPASH do të ketë një partneritet të simpertë dhe vëllazëror.

Kryetari i FSASH Xhafer Dobrushit, në përshëndetjen e tij, pasi vlerësoi lart frytën e bashkëpunimit mes dy sindikatave homologe, kërkoi që edhe në të ardhmen kjo frytë bashkëpunimi të forcohet më tej.

Më pas, Drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve Profesionale në MPCS dhe SHB Gjergji Muça, në përshëndetjen e tij në emër të Ministrit Kosta Barka, pasi vlerësoi SPASH si një partnere serioze dhe të denjë për mbrojtjen e interesave ekonomike e sociale të arsintarëve, i siguroi delegatët se tek dikasteri i tij, do të gjejnë kudoherë mbështetje për zgjidhjen e kërkesave të tyre nëpërmjet dialogut të simpertë.

Më pas, Kryetari i BSP-së së Tiranës, Gani Lani, pasi u përcolli delegatëve të këtij Kongresi përshëndetjet e të gjitha organizatave sindikaliste të kryeqytetit, i siguroi delegatët, ashtu si deri tani, për mbështetjen të fuqishme në të gjithë aktivitetin e SPASH. Në vijim, Kongresi



i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë Xhafer Dobrushit dhe Sekretari Ekzekutiv i saj Stavri Liko; delegacioni i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës të Kosovës i përbërë nga Ali Shabanaj, Kryetar, Zenel Zeka, Sekretar i Përgjithshëm dhe Ymer Ymeri, Manaxher i financave.

Nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, mori pjesë Gjergji Muça, Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve Profesionale.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, megjithëse ishte e ftuar në këtë Kongres, nuk denjoi të merrte pjesë me ndonjë përfaqësues, megjithë ftesën zyrtare të bëra Ministrit Pollo. Të paktën të respektonte ftesën dhe të dërgonte një përfaqësues në Kongresin e IV të kësaj sindikate, partnere sociale dhe kontraktuese në nivel të parë me këtë Ministri.

Ishin të ftuar dhe morën pjesë drejtues të tjerë të sindikatave të profesioneve dhe

që nga krijimi në vitin 1991 deri tani, lidhur ngushtë me aktivitetet konkrete, marrëveshjet dhe dialogun social, kontratat kolektive të purës të nivelit të parë të lidhura me Ministrinë e Arsimit e Shkencës, protestat dhe grevat e iniciuara e të drejtuara nga SPASH për nritjen e nivelit të jetesës së punonjësve të arsimit parauniversitar etj. Bashkëpunimi me FSASH dhe vlerësimi i këtij bashkëpunimi në lidhjen e kontratave kolektive të nivelit të parë dhe aktivitetave të përbashkëta si protesta e greva, ishte një pjesë e këtij raporti, i cili vijonte edhe me marrëdhëniet me sindikatat homologe evropiane e botërore ku aderon me të drejta të plota kjo sindikatë si p.sh. në Federatën Ndërkombëtare të Arsimit (EIT), si dhe projektet e realizuara me këtë rast. Në raport, një vend të konsiderueshëm zinte kualifikimi dhe formimi profesional i drejtuesve sindikalistë në bashkëpunim me FSASH. Organizimi dhe funksionimi i jetës së brendshme të kësaj sindikate, arritjet,

vazhroi me pyetje rreth raportit, përgjigjet përkatëse dhe diskutimet e delegatëve. Diskutimet e delegatëve të SPA nga rrethet dhe prefekturat e vëndit, trajtuan probleme të ndryshme të aktivitetit të tyre katërvjeçar, të arritjeve dhe mangësive në aktivitetin sindikalist sipas veçorive të secilit rreth si dhe propozuan rrugët që duhen ndjekur për përmirësimin e punëve dhe forcimin e sindikatës në të ardhmen.

Në pikën e dytë të rendit të ditës u diskutuan dhe u miratuan ndryshimet në Statutin e SPASH, u zgjodhën dhe u konstituan organet e larta drejtuese statutare. Më pas u hodh në votim vendimi i Këshillit Kombëtar të BSPSH-së që kandidatura e Gëzim Kalasë të paraqitet në kongresin e IV të BSPSH-së si kandidatura e vetme zyrtare, e shpallur për postin e Presidentit të BSPSH-së edhe për një mandat tjetër katërvjeçar. Në vijim u miratua edhe deklarata e aderimit të SPASH në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë. Në fund u kalua në zgjedhjen e kryetarit të SPASH, post për të cilin kandiduan tre drejtues sindikalistë: Bajram Kruja, kryetari aktual i SPASH, Dëfrim Spahiut, nënkryetar aktual i SPASH dhe Shpëtim Sina, kryetar i BSP-së së Qarkut të Fierit.

Me votim të fshehtë të 75 delegatëve, Bajram Kruja u rizgjodh në postin e kryetarit të SPASH me 36 vota, kundrejt Dëfrim Spahiut që fitoi 32 vota dhe Shpëtim Sinës që fitoi 4 vota. 3 vota u konsideruan të pavlefshme nga komisioni i votimit.

NGA STRATEGJIA E SPASH PËR KATËR VITET E ARDHSHME

"Të mendosh një vend të lirë dhe demokratik pa zhvilluar shkollën, ke menduar diçka që nuk mund të ndodhë"

SPASH do të vijojë të jetë edhe për katër vitet e ardhshme mbrojtëse dhe



avokate e mësuesve shqiptarë.

SPASH do të vijojë të jetë partnere e denjë sociale e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe do të vijojë të mbështesë Legjislacionin Shqiptar. SPASH do të kërkojë me forcë një partneritet real dhe efektiv.

Për realizimin e Kontratave Kolektive të Punës në të gjitha nivelet, lëvizjet sindikaliste dhe problemet e përbashkëta ekonomike e sociale të punonjësve të arsimit parauniversitar, SPASH do të bashkëpunojë me Federatën Sindikale të Arsimit dhe Shkencës

Për organizimin e brendshëm:

SPASH do të evidentojë listat e reja të aderimit të punonjësve të arsimit parauniversitar në SPASH, duke synuar shtimin e numrit të anëtarësisë.

E gjithë puna e SPASH për rritjen e numrit të anëtarësisë e forcimin organizativ do të përqendrohet në të gjitha qarqet, prefekturat dhe rrethet e vëndit dhe kryesisht në Tiranë, Durrës etj.

SPASH do të kërkojë që kuotizimi i anëtarësisë të derdhet në borderotë dhe në numrin e llogarisë së SPASH e prej këtu, të ndahet dhe të shlyhen detyrimet sipas Statutit.

Kryetari i SPASH të paguhet nga kuotat e anëtarësisë me vendim të Këshillit Kombëtar.

Për decentralizimin dhe reformën arsimore:

Duke i konsideruar si dy aspekte të ndryshme që ndodhin në të njëjtën kohë, ne do t'i mbështesim dhe do të punojmë si partnerët socialë më të afërt, si përfaqësues të mësuesve.

SPASH do të japë kontributin e saj, si pjesa më e rëndësishme e shoqërisë civile në këtë fushë.

SPASH, konsideron shumë të rëndësishme forcimin e ndikimit të komunitetit ku gjendet shkolla, të vetë shkollës dhe të kombinimit të të gjitha elementëve nëpërmjet Bordit të Shkollës.

SPASH do të punojë dhe luftojë që shërbimet të përmirësohen, duke konsideruar decentralizimin si veprimi që çon shërbimet në afër shkollës dhe reformën si veprimin që i përmirëson këto shërbime.

NGA STATUTI I SPASH:

SPASH aderon në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë me statusin e themeluesit prej vitit 1991

SPASH është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Arsimit (EI), me të drejta të plota nga muaji shkurt i vitit 1995.

SPASH ka marrëdhënie shumë të mira me Federatën e Mësuesve Amerikanë, (AFT)

SPASH ka marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Sindikale të Arsimit dhe Shkencës, (FSASH).

SPASH ka marrëveshje bashkëpunimi me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, (SBASHK).

Për formimin profesional dhe sindikalist, SPASH, në bashkëpunim me FSASH, do të vazhdojnë të zhvillojnë një sërë trajnimesh, takimesh, tryezash të rrumbullakëta, në bashkëpunim edhe me sindikatat holandeze, daneze, italiane etj.



Arsimi parashkollor, baza e sistemit arsimor, fushe e rendesishme per punen e sindikatave te arsimit

Nga Tryeza e Rrumbullaket organizuar nga EII ne Sofje

Problemet e arsimit parashkollor dhe rritja e rolit te sindikatave ne kete segment te sistemit arsimor ishin objekt i nje Tryeze te Rrumbullaket qe u organizua nga Federata Nderkombetare e Arsimit, EII, ne Sofje, me pjesemarrjen e drejtuesve te sindikatave anetare qe merren me keto probleme, si edhe te specialisteve te kesaj fushe dhe perfaqesuesve te organizmave te tjera ne nivel europian te angazhuara ne qeshtjet e arsimit parashkollor.

Ne kete aktivitet mori pjese edhe Sekretari i Pergjithshem i FSASH-it, Stavri Liko, i cili paraqiti situaten e sistemit arsimor parashkollor ne vendin tone dhe argzhimin e FSASH-it per rritjen e rolit te sindikatave ne kopshtet e femijeve, me synim permiresimin e gjithanshem te gjendjes, e cila aktualisht leper te dëshinuar.

Meas fjales se hapjes nga Koordinatori i EII per Europen, Z. Charlie Lennon dhe prezantimit te pjesemarrjesve, perfaqesuesja e sindikates suedeze, Anna Tornberg paraqiti draftin e politikave te EII per arsimin parashkollor, ku theksdhej fare qarte se 5-6 vitet e para te jetes jane shume te rendesishme per cdo njeri, prandaj arsimi parashkollor eshte baza e sistemit arsimor ne cdo vend dhe ai duhet te vlereschet si hapi i pare i arsimit baze dhe si pjese e rendesishme e nje sektori plotesisht te integruar ne sistemet kombetare te arsimit.

E drejta per t'u arsimuar eshte nje e drejte themelore e siguruar nga Deklarata Universale nbi te Drejtat e Njeriut, si edhe nga Konventa e OKB-se nbi te Drejtat e Femijeve.

Shifrat ne lidhje me pjesemarrjen e femijeve ne arsimin parashkollor jane te ndryshme ne vende te ndryshme. Sipas te dhenave te Raportit Monitorues te EFA te vitit 2005, veten 46.8 perqind te femijeve te moshes 3-6 vjec ishin te rregjistruar ne arsimin parashkollor ne shkalle boterore ne vitin 2001. Per vendet e Amerikes Veriore dhe Europes Perendimore kjo shifer ishte shume me e larte, rreth 87 perqind, afersisht e njejta si ne vitin 1998, ndersa ne vendet e Europes Qendrore e Lindore kjo shifer ishte rreth 60.2 perqind, shifer kjo shume me e larte krahasuar ne vitin 1998. Sipas vendeve, ka ndryshime te dukeshme. Keshtu Turqia ka shifren me te ulet, rreth 6.8 perqind te femijeve te rregjistruar ne arsimin parashkollor, ndersa Danimarka vlereschet

te kete 100 perqind te femijeve qe ndjekin arsimin parashkollor. Ndryshime ka, gjithashtu, edhe persa i perkret moshes se fillimit te arsimit te detyrueshem, nga 4 vjec ne Irlande, ne 7 vjec ne Danimarka, Finlande dhe Suedi.

Nje zhvillim pozitiv ne nivel europian konsiderohet fakti qe arsimi po behet universal per femijet nbi tre vjec, duke reflektuar nje kuptim te drejte te rendesise se arsimit parashkollor, por vazhdon te mbetet problem-pura ne femijet nen tre vjec.

Gjate diskutimeve ne kete Tryeze te Rrumbullaket u theksua se studime te besueshme tregojne se pjesemarrja ne arsimin parashkollor ka nje ndikim te drejtperdrejte ne rezultatet e munesve ne nivelet e tjera te arsimit. Shenbulli me kuptimplote ne kete drejtim eshte Zvicra, ku studimet evidentohet fare qarte lidhjen midis arsimit parashkollor dhe rezultateve ne matematike, kur munesit arrijne ne moshen 15 vjecare e ne vazhdim.

Por ndikimi i arsimit parashkollor shkon pertej rezultateve akademike. Megjithese studimet ne kete fushe nuk jane te shkurta, disa nga keto studime te realizuara ne disa shtete te Europes, ne Amerike, ne Zelanden e re, evidentojne qarte se ky ndikim duket qarte tek aftesite komunikuese dhe bashkepunuese, tek problemet me te pakta ne lidhje me menyren e sjelljes, tek perqindjet me ulat te baktisjes se shkollës dhe deri tek aktet me te pakta te kriminalitetit nder munesit dhe studentet qe kane marre pjese ne nje sistem parashkollor efektiv.

Duke folur ne kete aktivitet, Sekretari i Pergjithshem i FSASH-it, Stavri Liko, vuri ne dukje se arsimi parashkollor eshte shume i vleresuar edhe ne vendin tone. Ne ligjin nbi Arsimin Parauniversitar, perkrahohet se « Arsimi parashkollor publik eshte niveli i pare i sistemit te arsimit publik ne Republikene e Shqiperise ». Qellimi i ketij segmenti te arsimit ne vendin tone eshte arsimimi e zhvillimi i personalitetit femijeve dhe pergatitja per shkollen, ne synim qe te perballohen sa me mire detyrat e saj, veqanerisht ne vitet e para te shkollimit.

Rendesi e veqante i eshte treguar arsimimit te punonjesve te ketij segmenti te sistemit arsimor ne vendin tone. Kete e tregojne edhe shifrat e edukatoreve te kopshteve, 2 632 prej te cilave tani jane me arsim te larte, nga 3 716 qe jane gjithesejt.

FSASH i ka kushtuar kujdes te veqante krijimit dhe funksionimit te sindikatave ne kopshtet e femijeve, te cilat kane percaktuar prioritetet e veta sidomos per rritjen e pjeses se buxhetit per kete segment, ne kuadrin e gjithethe sistemit arsimor ne vendin tone, per rritjen e numrit te edukatoreve anetare te FSASH, per permiresimin e organizimit sindikal ne kete sektor, me qellim qe te permiresohen kushtet e punes dhe motivimi i ketyre punonjesve, per permiresimin e legjislacionit qe lidhet me arsimin parashkollor dhe per trajnimin e stafit pedagogjik te kopshteve.

Pas diskutimeve te shkurta, Tryeza doli me nje sere rekomandimesh ne lidhje me punen e sindikatave ne arsimin parashkollor, disa prej te cilave ishin:

- Sindikatat anetare te EII ne Europe duhet te jene aktive per te realizuar nje arsim parashkollor me cilesi te larte, si baza e sistemit arsimor ne cdo vend, duke krijuar mundesi per cdo femije qe te arsimohet qe ne moshen parashkollore.

- Te insistojne qe arsimi parashkollor te mbetet prioritet ne azhendet politike te qeverive dhe te bordeve te ndryshem nderqeveritare.

- Te insistojne per monitorimin e ritmeve te rritjes se sektorit privat ne kete sistem, nen mbikqyrjen e ministrise se arsimit ose organeve te tjera pergjegjese.

- Te synojne standarde te larta ne pergatitjen e stafit mesimor te arsimit parashkollor.

- Te kerkojne nga qeverite qe te rritet buxheti per arsimin parashkollor dhe te nxiten kerkimet shkencore ne nivel kombetar e lokal, me synim ngritjen e vazhdueshme te cilesise dhe efektivitetit te ketij segmenti te sistemit arsimor.

- Te synojne e kerkojne paga dhe kushte pune te barabarta per stafin arsimor te arsimit parashkollor, ahtu si edhe per gjithethe mesuesit e tjere.

- T'u kushtojne venedje te veqante problemeve te femijeve nen tre vjec.

Problemet e diskutuara dhe rekomandimet e miratuara ne kete Tryeze te Rrumbullaket do te jene objekt i veqante pune dhe per sindikatat tone te arsimit, me qellim qe edhe arsimi parashkollor ne vendin tone te eci perpara me te njejtat ritme si ne vendet e tjera te Europes.

Trajnime dhe plane veprimi konkrete per parandalimin e punes se femijeve

Nga seminarret e organizuara me ILO-IPEC ne Korçe, Berat dhe Elbasan

Ne vijim te aktiviteteve ne kuadrin e Programit me ILO - IPEC, Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, organizoi ne Korçe, Berat dhe Elbasan seminare te posacne per trajnimin e mesuesve sindikaliste qe jane te angazhuar ne punen me femijet dhe parandalimin e punes se femijeve.

Ne Seminarin e Korçes mermin pjese perfaqesues te kesaj Federate nga rrethet Korçe, Devoll dhe Kolonje, si edhe perfaqesues te Sindikates se Pavarur te Arsimit Shqiptar, SPASH, nga rrethi i

Kryetari i Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, zoti Xhafer Dobrushit dhe Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne Tirane, zonja Snezhi Bedalli.

Ne seminarin e Korçes moren pjese edhe drejtuesit kryesore te dy konfederatave per kete rreth, zoti Nebi Sulejmani, Kryetar i Keshillit Sindikal te KSSH dhe zonja Natasha Lubonja Kryetare e BSPASH per rrethin e Korçes. Edhe ne seminarin e Beratit dhe Elbasanit moren pjese kryetaret e Keshillave Sindikale te KSSH per keto rrethe, Loreta Ymeraj dhe

Snezhi Bedalli punoi me pjesemarresit ne te tre seminarret pothuajse gjate gjithe dites se pare. Ajo foli gjeresisht rreth konceptin rreth punen e femijeve, sqaroi se ku mund te vlihet nje vije ndarese midis asaj qe mund te pranchet dhe gjithnje formave te punes qe jane te papranueshme per femijet, u ndale hollesisht tek shkaqet e punes se femijeve dhe standardet nderkombetare ne lidhje me te, duke analizuar hollesisht Konventen Nr. 138 rreth moshen minimale te punesimit dhe Konventen nr. 182 rreth format me te keqja te punes se femijeve, si edhe legjislacionin shqiptar ne lidhje me kete ceshtje. Ne vijim, zonja Snezhi Bedalli shpjegoi disa nga Modulet kryesore te Paketes SCREAM, (Moeshtetja e Drejtave te Femijeve Nepermyjet Arsimit, Artit dhe Medias), e cila synon te angazhoje me mire mesuesit e te gjitha lendeve ne shkolla per terheqjen e nxenesve ne procesin e arsimit dhe te edukimit, nepermyjet formave te lamishme e terheqese per ta. Ajo u ndale, gjithashtu, ne shpjegimin e rendesise se monitorimit te punes se femijeve dhe projekteve qe jane ne zbatim ne vendin tone ne lidhje me kete ceshtje.

Te gjitha shpjegimet qe u bene nga zonja Snezhi Bedalli gjate dites se pare te tre seminarëve u shoqeruan me nje pjesemarrje aktive te mesuesve sindikaliste ne diskutime lidhur me situaten aktuale dhe konceptimin e ketyre problemeve nga ana e tyre, si edhe me ushtrime konkrete, siç ishin ato per njohjen me te mire me njeri - tjetrin ne procesin e punes ne seminare (Globingo) dhe rendesine e njohjen dhe respektimit te te drejtave te femijeve, (Balona me te drejta), te cilat u rekomanduan qe te perdoreshin gjeresisht nga pjesemarresit ne punen e tyre me nxenesit ose ne seminarret qe ata mund te organizojne me mesues te tjere ne baze shkollash ose rrethesh.

Seminarret vazhduan me prezantimin e Librit «Sindikatat dhe Puna e Femijeve», botuar ne kuadrin e ketij programi qe FSASH po zbaton me ILO-IPEC ne Tirane. Sekretari i Pergjithshem i FSASH, Stavri Liko beri shpjegime te hollesishme ne lidhje me Librin, duke u ndalur fillimisht tek puna e Organizates Nderkombetare te Punes



Korçes. Ne seminarin e Beratit mermin pjese perfaqesues te FSASH-it nga Berati, Kuçova dhe Skrapari, si edhe perfaqesues te SPASH-it nga rrethi i Beratit.

Ne seminarin e Elbasanit mermin pjese perfaqesues te FSASH e SPASH nga rrethet Elbasan e Gramsh dhe perfaqesues te FSASH nga Librazhdi.

Seminarret u paraprine nga nje pune e mire per gatitore, duke organizuar me pare takime ku u shperndane pyetesore ne lidhje me gjendjen dhe angazhimin e sindikatave te arsimit ne shkolla, si edhe te drejtorive te shkollave dhe mesuesve per ceshtjet qe kane te bejne me vijimin e nxenesve ne shkollë, me punen e vecante me nxenesit e veshtire, ose me nxenesit qe purojne etj.

Te tre Seminarret u drejtuan nga

Shpresa Barzhi.

Ne njerën nga seancat e seminarit te Beratit mori pjese edhe Drejtori i Drejtorise Rajonale te Arsimit, zoti Yzedin Hima. Po keshtu edhe ne seminarin e Elbasanit mori pjese ne njerën nga seancat edhe Drejtori i Drejtorise Rajonale te Arsimit, zoti Fatos Bajraktari.

Tre ishin synimet kryesore te ketyre seminarëve: Trajnimi i mesuesve sindikaliste ne lidhje me konceptin dhe standardet nderkombetare rreth punen e femijeve, prezantimi i Librit «Sindikatat dhe Puna e Femijeve» dhe analiza e gjendjes ne rrethet e Korçes, Beratit dhe Elbasanit dhe rrethet fqinje me to, duke per gatitur edhe planet perkatese te veprimit per punen me te ardhmen.

Ne lidhje me synimin e pare, zonja

Trajnime dhe plane veprimi konkrete per parandalimin e punes se femijeve

Vijn nga faqja 5

(ILO) dhe Zyres se saj per Aktivitetet e Punetoreve, ACTRAV, ne lidhje me eliminimin e punes se femijeve, tek nevojat qe diktuan botimin e ketij Libri ne shqip, tek vlerat e Librit dhe tek pamjetat e tij. Duke analizuar secilen prej te shtate broshurave qe perbejne Librin, ai u ndale sidomos tek Broshura e Dyte qe trajton hartimin e politikave sindikale dhe te planeve te veprimit per parandalimin e punes se femijeve, tek Broshura e Katert qe trajton organizimin e Fshatave kunder punes se femijeve, tek Broshura e Peste qe analizon perdorimin e Kontratave Kolektive per parandalimin e punes se femijeve, si edhe tek Broshura e Shtate qe trajton mardheniet tripaleshe kunder punes se femijeve. Pasi shpjegoi edhe kater referencat ne lidhje me format e punes se femijeve ne vendin tone, pervojën e FSASH e te sindikatave te tjera shqiptare ne lidhje me kete ceshtje, legjislacionin shqiptar mbi punen e femijeve, rolin e ILO-IPEC ne Shqiperi etj, ai u ndale tek vlerat e rendesishme te ketij Libri, jo vetem per mesuesit e per punen e femijeve, por edhe per tere levizjen sindikale ne vendin tone.

Ne seminare u bene diksitime ne lidhje me menyren e perdorimit te ketij Libri dhe u percaktuan detyra konkrete per organizimin e takimeve e te aktiviteteve te tjera per prezantimin e tij, sidomos tek mesuesit sindikaliste, por edhe me gjere.

Nje moment shume efektive i te tre seminareve ishte prezantimi i bere nga Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushi ne lidhje me vizionin e kësaj Federate e te sindikatave shqiptare ne pergjithesi ne lidhje me angazhimin per eliminimin e punes se femijeve. Ai u ndale hollesisht tek roli i FSASH-it, ne bashkepunim me SPASH-in per te siguruar nje angazhim efektive te mesuesve ne shkolla, duke siguruar nje pune konkrete me nxenesit qe braktisin shkollen dhe me ata qe jane ne rrezik per ta braktisur ate per shkak te kushteve ekonomike, por edhe per shkaqe te tjera qe lidhen me mentalitete te gabuara qe ende vihen re sidomos ne disa zona te thella ose ne periferi et qyteteve te medha nga prinder tardur ne keto zona, te cilet i pengojne, sidomos vajzat, qe te kryejne te pakten arsimin e detyrueshem, gje qe krijon premisa per t'i angazhuar ato ne

pune. Me tej, duke e konsideruar kete nje faze te re me te larte te aktivitetit te sindikatave te arsimit, zoti Dobrushi theksoi se ato po synojne qe te perfshijne ne kete angazhim edhe sindikatat e sektoreve te tjere ne perberje te KSSH-se dhe BSPSH-se, duke permendur ketu Rezoluten e Kongresit te Trete te KSSH-se, Konferencen Kombetare te organizuar per kete ceshtje nga KSSH e BSPSH, ne bashkepunim me Konfederaten Nderkombetare te Sindikatave te Lira, ICFIU etj.

Ne prezantimin e vete, zoti Dobrushi u ndale edhe tek synimet kryesore te Programit qe eshte duke u zbatuar ne bashkepunim me ILO-IPEC ne Tirane dhe tek Projekti tjetër qe dy sindikatat shqiptare te arsimit jane duke zbatuar ne bashkepunim me sindikaten e arsimit te Holandes, AOB.

Seminaret vijuan me raportimet e pjesemarresve mbi situaten ne shkollat perkatese ne baze te nje pyetesori te shperndare qe me pare, gje qe synonte te evidentonte problemet me kryesore ne lidhje me kete ceshtje ne keto mrete dhe ne shkollat qe perfaqesoheshin ne keto seminare, si edhe te perpildreshin plane konkrete veprimi per keto mrete e shkolla per nje pune me konkrete e me rezultative ne te ardhmen.

Ne raportimin qe beri ne Seminarin e Kroqes, kryetari seksionit sindikal te ketij mrethi, zoti Fildan Drako, vuri ne dukje se gjate vitit shkollor 2004-2005 ne kete mreth jane 134 nxenes qe kane braktisur shkollen, 46 prej te cileve jane vajza. Keto shifra, theksoi ai, jane rnder me te mirat gjate periudhes 1992-2005, por perseri shifra eshte shume e larte dhe shqetesimi shtohet kur pritet qe shumica e ketyre nxenesve t'u drejtohen fronteve te punes, perfshire edhe ato me te rrezikesmet. Nderkohe Kryetarja e Seksionit te SPASH-it per kete mreth, zonja Albina Pepo, dhe pjesemarres te tjere theksuan se akoma me i madh eshte numri i nxenesve qe jane ne rrezik per ta braktisur shkollen, gje qe duket ne vijimin me hope, ose ne angazhimin e tyre me pune, megjithese pa e braktisur perfundimisht shkollen.

Ne seminarin e Beratit, shifrat qe paraqiten Kryetari i seksionit sindikal te FSASH-it Berat, Ylli Muxogllava, Kryetari i seksionit te SPASH-it, Joli Papa,

Perfaqesuesi i SPASH-it per Kuçoven, Jordan Devole, Kryetari i Seksionit te SPASH-it per Skraparin, Perparim Musbelliu dhe mjaft pjesemarres te tjere ne raportimet e tyre ishin me te ulta, por shqetesimi se numri i nxenesve qe rrezikojne te braktisin shkollen ishte shume evident nga shume pjesemarres, duke paraqitur si faktore kryesore, jo vetem anen ekonomike, por edhe rolin e vete shkolles dhe mentalitetet qe nenvletojne rolin e saj, per shkak te mundesive te kufizuara qe ekzistojne per vazhdimin e shkolles se larte pas nibarimit te arsimit te detyrueshem.

Edhe drejtuesit e seksioneve perkatese te FSASH e SPASH ne Elbasan, Osman Niika e Bukuroshe Shabani e konsideruan te larte numrin e nxenesve qe kane braktisur shkollen ne kete mreth per vitin 2004-2005, prej mreth 650 nxenes, duke u angazhuar per nje pune me konkrete per uljen e ketij numri gjate ketij viti shkollor.

Pothuaje nga te gjithë pjesemarresit ne te tre seminare u theksua domosdoshmeria e nje bashkepunimi me efektive te sindikatave te arsimit me drejtorite e shkollave, me organet e pushtetit lokal dhe me organizatat e tjera joqeveritare qe jane te angazhuara ne kete ceshtje, perfshire edhe komitetet e prinderve dhe vete qeverite e nxenesve.

Pas raportimit te te gjithë pjesemarresve, ne te tre seminare u punua ne grupe me te vogla, ku u pergatiten edhe planet e veprimit per punen qe do te behet ne shkalle mrethesh e ne baze shkollash ne te ardhmen ne vijim te ketij Programi.

Disa nga detyrat kryesore qe u percaktuan ne keto seminare per Planet e Veprimi ishin:

-Te punohet me shume nga sindikatat e arsimit, duke perdorur trajnuesit e pergatitur si edhe Librin qe eshte botuar, per ndergjegjimsimin e mesuesve per domosdoshmerine e angazhimit me te madh ne lidhje parandalimin e punes se femijeve,

-Te aktivizohen sa me shume mesues per identifikimin e femijeve qe kane braktisur shkollen, te atyre qe jane ne rrezik per ta braktisur ate dhe te nxenesve me probleme ne vijim e ne mesime, me synim qe te orgnaizohet nje pune e vecante me secilin prej tyre, ne bashkepunim me prinderit e me

komunitetin,

-Te behen trajnime me nje numer sa me te madh mesuesish per Konventata 138 dhe 182, me qellim qe ata te njihen me standardet nderkombetare ne lidhje me punen e femijeve dhe te angazhohen per zbatimin e tyre,

-Te ndikohet tek drejtorite e shkollave dhe tek perfaqesuesit e pushtetit lokal qe ne qob shkollat te sigurohen nje numer i domosdoshem veglash muzikore dhe mjtesh te tjera sportive, dhe te sigurohet financimi i disa aktiviteteve edukative me femijet, me qellim qe te terhoqen sa me shume nxenes ne aktivitetet argetuese e zbavitese, si nje kusht i domosdoshem per parandalimin e largimeve nga shkolla,

-Te përpilohet nje harte e shkollave ne shkalle rrethi, ku te evidentohen shkollat me me shume probleme dhe te synohet qe te punohet konkretisht ne menyre te diferencuar me keto shkolla, duke synuar qe te behen edhe aplikime per te siguruar ndihme nepemijet miniprogrameve qe mund te zbatohen,

-Nga ana e kryesive te FSASH dhe SPASH ne qender te shfrytezohen bisedimet per kontraten e re kolektive te punes per te perfshire ne nene te vecanta te saj ceshtjet qe kane te bejne me eliminimin e braktisjes se shkolles dhe te punes se femijeve, si edhe me pemiressimin e legjislaconit dhe masat shtrerguese per zbatimin e tij, ne rastet e braktisjes se

shkolles,

-Te zbatohet nje program pilot te pakten ne 3-5 shkolla te rretheve pjesemarrrese ne keto seminare per ngritjen e stendave te sindikatave ku te afishohen materiale te ndryshme qe lidhen me eliminimin e punes se femijeve,

-Te krijohen Grupe te vecanta koordinuese ne baze rrethi, (Korce, Berat, Elbasan), per ndjekjen e zbatimit te planeve te veprimit dhe per zgjerimin e angazhimit te mesuesve ne problemet qe lidhen me eliminimin e punes se femijeve.

Ne te tre seminarat iu kushtua nje kujdes i vecante perdorimit te medias per t'u bere jehone seminareve dhe per siguruar nje angazhim gjithnje e me te gjere te te gjitha mesuesve per keto probleme kaq te rëndësishme per nxenesit, per femijet dhe per gjitha shoqerine tone. Perverc pasqyrimin te ketyre seminareve ne televizionet lokale dhe ne ato kombetare, nepemijet korrespondenteve lokale, ne te tre rrethet u bene emisione te posaqme ne lidhje me seminarat dhe me angazhimin e sindikatave te arsimit e sindikatave te tjera, ne bashkepunim me Zyren e ILO-IPEC ne Tirane, per mbrojtjen e femijeve dhe parandalimin e punes se tyre. Ne emisionin e drejtperdrejt qe u organizua ne TV « Lobi » ne Korce, Kryetari i FSASH, zoti Xhafer Dobrushki, Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne vendin tone, zonja Snezhi Bedalli dhe

Drejtoresha e Shkolles « Demokracia » Kostanca Qari, trajtuan hollesisht punen e bere ne shkalle vendi dhe vecanesisht ne rrethin e Korces, ne lidhje me kete problem, duke bere thirrje per nje angazhim te te gjithave dhe te te gjitha strukturave per eliminimin e punes se femijeve.

Kjo gje u theksua edhe ne emisionin e posaqem qe u transmetua nga TV «Onufri» dhe ne lajret qe transmetuan disa televizione te tjera lokale ne Berat.

Ne programin e organizuar ne TV «Egnatia» ne Elbasan, pervec zotit Dobrushki dhe Zonjes Bedalli, moren pjese edhe dy drejtuesit e seksioneve sindikale te arsimit ne kete rreth, Bukurisha Shabani dhe Osman Nika.

Ne perfundim te te tre seminareve, me nje fame shume interesante, secili prej pjesemarrresve beri vleresimin e seminarit ne lidhje me kater ceshtje kryesore qe kishin te benin me te: niveli i organizimit, niveli trajnuesve, metodat e perdorura dhe materialet e vena ne dispozicion te pjesemarrresve. Organizatoret e seminareve nxoren mesimet e nevojeshme ne lidhje me vleresimet preterduse per me shume, gje qe do te mbahet parasysh ne aktivitetet ne vijim te ketij programi ose te projekteve te tjera qe pritet te zbatohen dy sindikatat e arsimit ne lidhje me eliminimin e punes se femijeve ne vendin tone.

Stavri LIKO

Pervoje nga Shkolla 9 - Vjeçare "Dino Ismaili", Levan, Fier

TOMOR HOXHA
Drejtor i Shkolles



Në këtë detyrë kam 3 vjet që punoj, që nga shtatori i vitit 2002. Gjatë gjithë kësaj kohe i jam përkushtuar punës si drejtues dhe menaxher i procesit mësimor edukativ në këtë shkollë.

Shkolla jonë në përbërje të saj ka cikline lartë 9 - vjeçare, cikline e ulët fillor, kopshtin dhe 2 grupe me fëmijë romë që vazhdojnë kurset kundër analfabetizimit. Gjithsej në këtë shkollë në të gjitha ciklet janë 650 nxënës dhe japin mësim 32 mësues. Drejtoria përbëhet nga 3 anëtarë: drejtori dhe dy zv/drejtorë. Kemi një staf mësimor të kualifikuar dhe të përkushtuar për punën. Si drejtor jam përpjekur që me punën, përkushtimin, aftësitë dhe profesionalizmin tim, të drejtoj dhe bashkërendoj punët për të gjitha problemet, detyrat dhe realizimin e objektivave që ka marrë shkolla në vitin mësimor 2005-2006. Gjatë gjithë këtyre viteve shkolla ka mirë dhe realizim të objektivave dhe ajo është pasqyruar edhe në rezultatet e nxënësve, në kaluesmërinë dhe cilësinë e tyre. Kemi intensifikuar edhe punën edukative dhe

kjo ka bërë që toleranca, mirëkuptimi, formimi dhe sjellja e nxënësve në shkollë të jetë e mirë. Për pasojë, nuk kemi thyerje të disiplinës në shkollë. Punë të mirë kemi bërë si drejtori e si këshill mësuesish në sigurimin e kontingjentit të nxënësve dhe sidomos në sjelljen e fëmijëve romë në shkollë. Si drejtor unë kam mbajtur vazhdimisht lidhje e kam bashkëpunuar me shoqatën "Anarodrom". Ne, krahas nxënësve romë që vijjnë rregullisht në shkollë, kemi edhe dy grupe që bëjnë kurse kundër analfabetizimit. Nuk kemi dukuri të trafikimit të fëmijëve si dhe të përdorimit të drogës. Ne bëjmë një punë të vazhdueshme dhe rezultatet janë shumë të mira. Kemi shkollë e ambiente të pastra e të kulturara, të përshtatshme për mësim. Drejtoria e shkollës dhe mësuesit edhe në të ardhmen do të vazhdojnë të punojnë me përkushtim.

Vijon në faqen 10

Vijon nga faqja 9

ROVENA RUKO
Mësuese ne Ciklin e Ulët



Kam mbaruar shkollën e lartë në Vlorë, Universiteti "Ismail Qemali", dega Cikël i Ulët. Jam mësuese në shkollën 9 - vjeçare "Dino Ismaili", Levan, që prej 3 vjetësh. Këtë vit kam kujdestari klasën e II C. Klasa ime përbëhet nga 24 nxënës. 9 prej tyre janë fëmijë romë. Klasa ka nivel mesatar. Kam punuar vazhdimisht me metoda bashkëkohore. Kam bërë punë të diferencuar veçanërisht me nxënësit romë, pasi vështirësitë e tyre kanë qenë më të mëdha në krahasim me nxënësit e tjerë. Në klasën e parë kishin probleme me të folurit dhe të shqiptuarit e gjuhës shqipe. Kam bashkëpunuar me prindërit dhe falë edhe ndihmës së tyre në shtëpi dhe punës sime, kemi arritur rezultate të mira. Kemi zhvilluar shpesh herë aktivitete të ndryshme brenda e jashtë shkollës. Nxënësit kanë marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin. Kam zhvilluar tek ta dëshirën për të ndihmuar shokët e shoqet që kanë rezultate më të ulta për të qenë të gjithë së bashku një klasë shëmbullore. I kam njohur ata me rregullat që duhet të kenë parasysh brenda këtij ambienti. I kam mbajtur më afër nxënësit romë në mënyrë që ata mos ta ndiejnë veten të veçar, por pjesë të kësaj shoqërie. Do të punoj e do të angazhohem edhe më shumë në të ardhmen për të arritur rezultate më të larta.

ANILA DUVAJ
Mësuese ne Ciklin e Ulët

Kam mbaruar studimet në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, dega Cikël i Ulët. Punoj prej 5 vjetësh si mësuese e ciklit të ulët pranë shkollës 9 - vjeçare Levan. Këtë vit jam mësuese kujdestare e klasës së II A. Klasa ime përbëhet nga 24 nxënës. Niveli i përpërimit të nxënësve është mesatar. 9 prej nxënësve në klasë janë romë. Jam përpjekur të eliminoj dallimin racial mes nxënësve të klasës. Nxënësit kanë marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin. Kam bashkëpunuar me prindërit e tyre për probleme të frekuentimit dhe përpërimit. Vështirësi në përpërimitin e nxënësve romë ka patur sidomos në fillim të klasës së parë, pasi disa prej tyre nuk njihnin ose flisnin shumë pak gjuhën shqipe. Dobësi të mëdha kishte tek fëmijët romë që kishin prindër të paarsimuar. Këta nxënës më tepër vështirësi shfaqin me lëndën "Gjuha Amëtare" ndërsa me matematikën përpërojnë lehtësisht. Tashmë dy prej tyre janë në nivelin "shumë mirë", tre në nivelin "mjaftueshëm" dhe të tjerët (katër) janë nxënës me nivel mesatar.



I kam aktivizuar edhe në veprimtari jashtë shkollore ku kam zbuluar dhe nxitur talentin e tyre në muzikë, vizatim, veprimtari sportive. Më është dashur të punoj shumë edhe me prindërit e komunitetit tjetër, pasi nuk lejoni fëmijët e tyre të shoqëroheshin me fëmijët romë, megjithëse vetë fëmijët kishin dëshirë të rrinin bashkë. Këtë vit

është zbehur plotësisht ky dallim. Nxënësit romë ulen në bankë me nxënësit e tjerë.

Në klasë aplikoj shumë punën në grupe dhe gjatë mësimit përdor metodat bashkëkohore ku mbizotëron puna e nxënësve. Programi i ri 9-vjeçar është mjaft i përshtatshëm për nivelin e fëmijëve, është shumë pranë botës së tyre dhe kjo bën që të realizohen orë mësimi efektive dhe të kënaqshme.

N ATASHA ZEQAJ
Mësuese në Ciklin e Ulët



Profesionin e mesueses ushtroj që prej 34 vjetësh. Jam shumë e kënaqur me punën që bëj. Të punosh me fëmijët është po aq e lukur sa dhe e vështirë.

Në komunitetin tonë përbërja e popullsisë është heterogjene. Gjatë punës sime jam munduar që të sheshoj dallimet midis fëmijëve të bardhë e atyre romë. Romët i kam vendosur në banka bashkë me fëmijët e tjerë, i aktivizoj njësoj si të bardhët, mbaj lidhje të ngushta me prindërit e tyre. Kemi organizuar festa ku janë festuar ditëlindjet e fëmijëve romë. Kemi ndihmuar një fëmijë rom i cili ishte dobët nga ana ekonomike. Një shok i tij solli disa rroba nga të tija dhe ia dhuroi. Rasti tjetër ishte kur u qpena nxënësi L.L. Fëmijët i shkuan në shtëpi ku dhe i qvan një sasi të vogël lekësh të cilat i mblohën sipas mundësive.

Tek fëmijët kam edukuar ndjenjën e dashurisë për njëri-tjetrin pa dallim ngjyre. Tani fëmijët pothuajse e kanë kaluar këtë fazë dhe ndjehen të barabartë.

“Duhet të sigurojmë që Rezolutat të përputhen me veprimet”



Intervistë me Presidentin e Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, Thulas Nxesi

Për Presidentin e Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, sindikatat e mësuesve do të përfitonin nga krijimi i aleancave me përfaqësuesit e shoqërisë civile për të përparuar në çështjen e arsimit publik cilësor në të gjithë botën.

të përshtatshme të edukatorëve të jenë një investim afatgjatë dhe jo thjesht një harxhim financiar. Trajnimi dhe zhvillimi fuqizojnë edukatorët për të siguruar një shërbim cilësor.

Federata Ndërkombëtare e Arsimit është, gjithashtu, një avokat mbrojtës i zjarrtë i arsimit cilësor si një e mirë publike. Ne kemi nënvizuar rrezikun e privatizimit dhe komercializimit të arsimit ku do të përfitonin vetëm të pasurit dhe do t'i linin shoqëritë tona në të ndara se kurrë.

Nëse ekziston vullneti politik, financimi mund të gjendet. Shikoni sasinë e parave të harxhuara në lufta që duhet të ishin investuar në shkolla dhe arsimit paqësor. Në vendet në zhvillim, synimi i EFA, (Arsimim Për të Gjithë), për të siguruar arsimim për të gjithë fëmijët deri në vitin 2015 duket i paspresë për t'u realizuar, për shkak të mungesës së financimeve të qeverive. Mësuesit shpesh sakrifikojnë veten e tyre duke punuar me orar të zgjatur me klasa të tejmbushura. Shumë para i janë mohuar arsimit për shkak të korrupsionit, pagesave të borxhit të jashtëm, politikave të krijuara për të ulur rolin e shtetit dhe shkurtimeve të shpenzimeve publike.

Nuk do të ketë arsimim cilësor nëse nuk mendohet të plotësohen kushtet bazë të punonjësve të arsimit. Në shumicën e vendeve në zhvillim, pagat e mësuesve dhe kushtet e punës janë akoma shumë të varfëra. Ndonjëherë mësuesit i marrin pagat e tyre vonë ose madje duhet të heqin dorë prej tyre. Në këto kushte, është shumë e vështirë të flitet për arsimim publik cilësor për të gjithë.

Çfarë mund të bëjnë sindikatat tona për të përmirësuar kushtet e punës të mësuesve?

Fillimisht, sindikatat duhet të

zhvillojnë aftësitë e tyre të negociimit, jo vetëm për kushte shërbimi, por edhe për çështje sociale dhe ekonomike. Sindikatat duhet të arrijnë të sigurojnë njohuri të hollësishme mbi çështje komplekse si komercializimi etj, sepse, në të kundërt, çfarë do të bëjnë ato kur të thirrren në tryezën e negociatave? Për sa i përket Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, ajo duhet të vazhdojë të angazhohet me Bankën Botërore në mënyrë që të qëndrojnë në një hap me Iniciativën Hapa të Shpejta për të financuar Arsimimin Për të Gjithë. Aty ku dispozitat publike për këtë arsimim ekzistojnë, sindikatat duhet të mobilizohen për t'i mbrojtur ato nga ata që kërkojnë t'i dobësojnë. Sindikatat e mësuesve duhet të ndërtojnë, gjithashtu, aleanca në OJQ-të për të diskutuar për përmirësimin e shpenzimeve për ndihmën në zhvillim dhe për arritjen e objektivit 0.7% të GDP për asistencën e zhvillimit dhe bashkëpunimit. Organizatat anëtare të Federatës Ndërkombëtare të Arsimit ndërtojnë një koalicion të suksesshëm me sindikata të tjera dhe me organizata të shoqërisë civile nën Thirrjen Botërore për Veprime kundër Varfërisë.

Ju përmendët, gjithashtu, synimin për një rregull të ri botëror të bazuar në paqe, drejtësi sociale, siguri dhe angazhim për të mbrojtur të drejtat e njëriut dhe të sindikatës.

Federata Ndërkombëtare e Arsimit është pjesë e një zgjidhjeje botërore të forcave progresive për ndryshime sociale dhe drejtësi. Ne mund të shpresojmë nga elasticiteti i lëvizjes botërore të punës që refuzon të nënshtrohet para globalizimit të përbashkët. Ne shpresojmë nga energjia e krijimit të lëvizjeve të reja sociale në terrenin ku përfaqësohen të

Një vit më parë ju u zgjodhët President dhe atëherë e konsideruat këtë si një nder dhe një sfidë së bashku. Cila është ndjesia juaj tani?

Më lejoni, në radhë të parë, të përhendes afërsisht 30 milion anëtarët tanë në mbarë botën, 30 milion mësues të përkushtuar që mbrojnë zhvillimin social dhe luftojnë për një të ardhme në të mirë. Anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Arsimit janë boshti kryesor në luftën për arsimim publik cilësor, në fund të fundit, janë ata që duhet ta realizojnë atë.

Po, vitin e kaluar në Brazil, përfaqësuesit e mësuesve dhe punonjësve të arsimit, të politikave dhe strategjive botërore të zhvillimit, shqyrtuan çështjen e arsimit publik cilësor dhe interesat e punonjësve në arsim. Ata, gjithashtu, preferuan të zgjidhnin si President një kandidat nga jugu. Unë mendoj se kjo është shumë e rëndësishme dhe falenderoj të gjitha organizatat anëtare të Federatës Ndërkombëtare të Arsimit për mbështetjen e tyre.

Ju identifikuat katër tema thelbësore për sindikatat e mësuesve: njëra prej tyre ishte lufta për arsimim publik cilësor për të gjithë.

Arsimimi cilësor, veçanërisht për vajzat dhe gratë, është ama më e fuqishme për të çmënjësuar varfërinë, sëmundjen dhe urinë. Arsimiti dhe trajnimi janë, ashtu siç është diskutuar nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit, një investim për të ardhmen. Qeveritë duhet të vlerësojnë që burimet e përdorura për trajnim dhe mbështetje

“Duhet të sigurojmë që Rezolutat të përputhen me veprimet”

Vijon nga faqja 11

shpronësuarit dhe të shtypurit. Në disa raste, ne mund të festojmë, gjithashtu, zgjedhjen e qeverive demokratike të angazhuara në drejtësinë sociale, siç është qeveria ime në Afrikën e Jugut. Ne nuk duhet të kemi frikë të nështesim qeveri të tilla, për aq kohë sa ato qëndrojnë vigjilente në mbrojtjen e interesave të anëtarëve tanë.

vendosmërisht flet hapur mbi abuzimet me të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat politike dhe të punës, të drejtat e grave dhe të fëmijëve. Sindikalistët e keqtrajtuar, nxënësit mbi të cilët abuzohet, edukatorët femra që përballen me shtypjen dhe ata që vuajnë nga paragjykimet e çfarëdolloji meritojnë vëmëndjen dhe solidaritetin tonë të menjëhershme.

duhet të jami në gjendje të ndikojmë në lëvizjen sociale në atë pjesë të botës. Nëse investitorët po lëvizin tani masivisht drejt Kinës, Federata Ndërkombëtare e Arsimit ka nevojë të gjejë mënyra për t'u përfshirë në lëvizje sindikale të pavarura në Kinë. Si do t'i përkufizonit atëherë lidhjet formale është një pyetje tjetër, por Federata Ndërkombëtare e Arsimit ka nevojë të angazhohet në dialog në lidhje me këtë çështje.

Ju jeni nxitës i zjarrtë i aleancave me grupe të tjera sociale.

Po, si banor i Afrikës së Jugut, unë e di fuqinë e bashkimit me lëvizjen studentore dhe organizatat e komunitetit, ashtu siç bënë për të shfuqizuar regullin Aparteidit në vitet 1980. Sindikatat e mësuesve duhet të interesohen për çështje sociale dhe politike për të siguruar që të kemi një qeverisje të mirë, veçanërisht në shoqëritë që po shkojnë drejt demokratizimit. Sindikatat duhet të bashkohen për të ndikuar mbi qeveritë e tyre dhe të influencojnë politika mbi një bazë ditore. Ne duhet të krijojmë aleanca me grupet e kishës, lëvizjet e prindërve, grupe sociale progresiste mbi çështje me interes të përbashkët.

Nuk mund ta fitojmë vetëm betejën për arsimit publik cilësor për të gjithë. Prandaj, Fushata Botërore për Arsim është një shembull i mirë ku Federata Ndërkombëtare e Arsimit dhe sindikatat e mësuesve janë një forcë kryesore, sepse sindikatat janë për fuqi masive.

Më lini të sqarohem në këtë pikë: disa OJQ përfaqësojnë vetëm një grup të vogël aktivistësh. Si sindikalistë, filozofia dhe vizioni ynë bazë nuk ndryshojnë: parimet e solidaritetit, barazisë, demokracisë, zhvillimit social janë po aq të vlefshme aktualisht sa kanë qenë gjithmonë. Por strategjia dhe taktikat duhet të rishikohen dhe ndryshuar gjithmonë, në përputhje me rrethanat e reja.

Cili është vizioni juaj për Federatën Ndërkombëtare të Arsimit për 10 vjet?

Zëri ynë duhet të forcohet. Të gjithë liderët e punës, në nivel ndërkombëtar



Kongresi Botëror i Federatës Ndërkombëtare të Arsimit nxori në pah çështje të paqes dhe sigurisë botërore. Lufta dhe pasiguria i bëjnë qëllimet e Arsimimit Për të Gjithë dhe zhvillimin social të paarritshëm, veçanërisht në disa zona të Afrikës dhe Lindjes së Mesme. Ne kemi nevojë për institucione të shumanshme, të fuqishme, që mund të lehtësojnë marrëveshjet e negociimit, të promovojnë qeverisje të mirë dhe të sigurojnë ndihmën e mundur për kombet e varfëra. Federata Ndërkombëtare e Arsimit po shpreh, gjithashtu, shumë qartë indignatën e saj kundër terrorizmit në të gjithë paraqitjet e tij, qoftë terrorizmi i shtetit ose ai i kryer nga forca të tjera. Arsimi duhet të predikojë të fëmijët vlera dhe zgjidhje paqësore të konflikteve.

Federata Ndërkombëtare e Arsimit

Tema e fundit ishte krijimi i bashkimit të mësuesve për të përmirësuar kushtet e punonjësve të arsimit.

Kongresi i Katërt Botëror votoi në numër të madh në favor të pranimit në Federatën Botërore të Arsimit të kolegëve tanë nga organizatat anëtare europiane të Konfederatës Botërore të Mësuesve.

Federata Ndërkombëtare e Arsimit duhet të angazhohet, gjithashtu, në lëvizjen e mësuesve në Kinë, në Lindjen e Mesme, në Kubë. Nuk mund të lihen jashtë nesh miliona mësues në Kinë. Duhet të pranojmë që jetojmë në një botë të globalizuar dhe nuk duhet të jami arrogant: ideologjitë e ndryshme nuk duhet të na udhëheqin drejt lënies së tyre në izolim. Nëse duam të arrijmë bashkimin e lëvizjes së mësuesve, ne

dhe kombëtar, duhet të hapin një debat organizativ dhe politik për të analizuar saktësisht ku jemi tani dhe afërsisht ku duam të jemi pas një kohe të gjatë. Lëvizja e mësuesve, gjithashtu, ndeshet me sfidën e globalizimit, liberalizimit të ri dhe sulmeve mbi shërbimet publike. Ne jemi dëshmitar të një ristrukturimi ekonomik gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, të shoqëruar me krijimin e tipave të rinj të punonjësve. Në të njëjtën kohë sektorë më të vjetër, minierat, bujqësia dhe industria e rëndë, janë dobësuar, shpesh duke rezultuar në dobësim të marrjes në punë dhe rënie të anëtarësisë së sindikatave. Si një lëvizje, ne duhet të pyesim nëse kemi bërë ç'është e nevojshme për të përballuar këto sfida të reja.

Është e rëndësishme për ne të mos harrojmë objektivin final, që si sindikalistë dhe edukatorë, në mënyrë që të arrijmë synimet tona për kushte më të mira dhe arsimim cilësor, ne duhet të angazhohemi me lëvizjet në të gjëra për zhvillimin social.

Bashkëpunimi për zhvillim, gjithashtu, ka nevojë të mbështetet. Vendet veriore kanë si detyrë të mbështesin kolegët e tyre nga jugu. Po përmend vetëm eksperiencën time. Në vitet 1980 dhe 1990, kur po krijonim sindikatën e parë joraciste të Afrikës së Jugut, ne u mbështetëm shumë në solidaritetin dhe financimet nga sindikatat në jug. Ne krijuam SADIU në vitin 1990 me këtë lloj mbështetjeje. Jam i luntur të njoftoj se 15 vjet më vonë kjo sindikatë është e pavarur. Duke pasur 220,000 anëtarë ne japim një kontribut madhor në lëvizjen e gjerë të Afrikës së Jugut dhe ne u transmetojmë një ndihmë bashkëpunimi për zhvillim sindikatave në vendet fqinje. Solidaritet është, gjithashtu, shkëmbimi i njohurive të thjeshta dhe të veçanta, i aftësive dhe burimeve njerëzore. Veriu mund të mësojë shumë nga vlerat njerëzore të të ashtuqajturit jug.

Përfundimisht, Federata Ndër-kombëtare e Arsimit dhe organizatat e saj anëtare duhet të sigurohen që rezolutat të përputhen me veprimet. Ne mund të vazhdojmë të miratojmë rezoluta, por duhet të veprojmë me vendosmëri për t'i zbatuar ato.

BASHKËPUNIM I FRYTSHËM I KËSHILLIT SINDIKAL ME DREJTORINË

(Në shkollën 9-vjeçare "Ali Demi"-Tiranë)

1.

Në një stendë të veçantë, me emërtimin "Tribuna Sindikale", në shkollën 9-vjeçare "Ali Demi" të kryeqytetit, herë pas here shpallen objektivat dhe detyrat kryesore, që marr përsipër të zgjidhë këshilli sindikal, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës. Ndër të tjera, aty është vendosur fotografia e kolektivit mësimdhënës, bashkë me zotimet kryesore, të cilat janë:

1. Të arrijmë nivel të lartë shkencor, përmes përgatitjes dhe punës vetjake të secilit;

2. T'i edukojmë nxënësit tanë me qytetari të lartë;

3. Të përgatitim e zhvillojmë veprimtari të vazhdueshme për edukimin dhe argëtimin e mësuesve e nxënësve.

kujdes i posaçëm për mësimin e gjuhës frënge, si një ndër shkollat-pilot të Tiranës, u përgatit një shfaqje muzikoletrare në këtë gjuhë. Mermin pjesë nxënës e mësues dhe prindër e banorë të tjerë të komunitetit. Fëmijët frankofonë paraqitën para tyre recitime, fabula, skeçe, këngë etj. Kështu ata dëshmuuan aftësitë e tyre në përvetësimin e kësaj gjuhe dhe u manifestuan repeketi e dashuria e tyre ndaj gjuhës e kulturës së lashtë franceze.

Por nuk është vetëm kjo veprimtari që dëshmon lidhjet e kësaj shkolle me Francën. Duke pasur dhe mbështetjen e ambasadës përkatëse në Tiranë, me ndihmën e Shoqatës kulturore "Nekal", mësues e nxënës të shkollës "Ali Demi" kanë bërë një vizitë të pamuar në Paris. Përveç njohjes me bukuritë e traditat e këtij vendi mik, atyre u vlejti



Në vazhdim të zbatimit të këtyre detyrave, jo shumë kohë më parë u zhvillua një veprimtari e bukur dhe mbresëlënëse. Meqenëse tregohet

kjo vizitë për ta përvetësuar ende më mirë gjuhën franceze. Më pas ata pritën me dashuri e bujari në mjediset e

BASHKËPUNIM I FRYTSHËM I KËSHILLIT SINDIKAL ME DREJTORINË

Vijn nga faqja 13

shkollës së tyre disa mysafirë francezë.

Siç vazhdon të tregojë kryetarja e këshillit sindikal, znj. Fatbardha Keço, vizita të organizuara me synime të caktuara dhe lidhje e bashkëpunim me kolektiva shkollash kanë realizuar ata dhe me Kosovën e Malin e Zi. Ndërsa tani po përgatiten të bëjnë një vizitë tjetër në Kroaci. Përveç masave të marra në këtë drejtim nga drejtorja e shkollës, ka rënë në sy puna e mirë e këshillit sindikal. Për këtë qëllim janë dalluar disa veprimtarë, ndër të cilët janë edhe Elda Liço, Theodhora Xhexhi e Hurma Elezi.

Pra, një fushë e rëndësishme e veprimtarisë jashtëshkollore të këshillit sindikal në këtë shkollë është ndihma e bashkëpunimi në zhvillimin e veprimtarive kulturore-artistike. Kjo gjë është arritur mjaft mirë edhe me raste festash e datash përkujtimore. Kështu, për shembull, janë dhënë shfaqje të bukura me rastin e fillimit të mësimeve, për festat e Nëntorit dhe po bëhen përgatitje të mira për Krishtlindjet e Vitit të Ri. Ndër këto veprimtari janë dhe konkursi i këngës partizane dhe ai për njohjen e jetës e veprimtarisë së Heroit të Rpuçllit Ali Demi, emrin e të cilit e mban me nder kjo shkollë.

2

Këshilli sindikal në këtë shkollë zhvillon jetë të gjallë, aktive. Rregullisht çdo muaj bëjnë mbledhje, ku analizohen arritjet dhe caktohen detyrat për të ardhmen. Ndër të tjera, aty diskutohet dhe për marrëdhëniet me çdo anëtar të kolektivit. Siç dihet, në kolektivat arsimorë ka shokë e shoqe që mbushin moshën e pensionit. Pra, kësaj ngjarjeje të rëndësishme në jetën e mësuesve, i kushtohet rëndësi e dorës së parë, nuk lihet në harresë. Kështu mbodhi edhe para se të dilnin në pension Zyra Haderi, Luan Isufi e Shpresa Kolaneci, kur u mbledhën të gjithë e kaluan bashkë orë të gëzuara. Gjithashtu, më pas janë kujdesur për jetën dhe veprimtarinë e shoqëve të tyre në pension.

Znj. Fatbardha Keço është dhe Kryetare e Seksionit Sindikal për Tiranën Qytet. Ajo tregon se jo vetëm në kolektivin e saj, por dhe në kolektivat e tjerë shkollore, gjithashtu, veprimtaria sindikale synon të përqendrohet në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të arsimtarëve, siç është dhe rritja e pagës mujore. Po kështu, vëmendje tregohet për përballimin e detyrave që dalin në luftën ndaj korrupsionit, për parandalimin e rasteve të mitnarrjes, përdorimit të drogës, alkolit etj. Si për këto dukuri dhe për përdorimin e notës jashtë kriterëve të përcaktuara ose për organizimin e kurseve jashtëshkollore me pagesë, janë bërë teste e anketime me nxënës e prindër dhe ka dalë se në këtë kolektiv nuk ka raste të tilla dhe gjerëja është nën kontroll të vazhdueshëm.

3

Siç na njohin sindikalistët, por dhe drejtoresha znj. Zana Çobo e zv.drejtori z. Mark Ucaj, shkolla 9-vjeçare "A.Demi" dallohet ndër simotrat e saj në Tiranë. Sivjet aty vazhdojnë 714 nxënës dhe u japin mësim 30 arsimtarë. Vlen për t'u shënuar se kalueshmëria e arritur vitin e kaluar, 90 për qind dhe nota mesatare 8.2, janë për t'u përshëndetur edhe për faktin se të gjithë tani synojnë për më shumë, pra nuk janë të vetëkënaqur. Drejtorja e shkollës ka bashkëpunuar me këshillin sindikal për hartimin e karakteristikave vjetore të punës së mësuesve. Duke marrë parasysh mendimet e kolegëve, mësuesve dhe prindërve, u shpall "Mësuesja e vitit", që ishte znj. Lindita Gëb (fizikë). Po kështu, për arritje të mira në procesin mësimor-edukativ janë dalluar edhe Vera Bodi (matematikë), Elda Liço (gjuhë shqipe), Henrieta Vozga (frëngjisht), Elvana Çoçoli (anglisht), Valentina Bakiri (cikli ukët), Aishe Gjeka (Cikli ulët).

Zotimet e mësuesve dhe objektivat, që do të arrijnë në vazhdimësi janë bërë të njohura për nxënësit, prindërit dhe

gjithë komunitetin. Rritjen e mëtejshme të nivelit cilësor në tërë veprimtarinë mësimore-edukative, në shkollë e jashtë saj, e bën të mundur dhe niveli i kënaqshëm profesional i anëtarëve të trupës pedagogjike. Ata janë të gjithë me arsimin përkatës dhe bëjnë përpjekje të parreshtura për përvetësimin e të rejavë të shkencës pedagogjike dhe të lëndës që japin mësim. Kënaqësinë e mësuesve dhe të prindërve e shton edhe fakti se nxënësit, që kanë mbaruar klasën e tetë në shkollën "Ali Demi" dhe ndjekin mësimet sidomos në shkollën e mesme "Ismail Qemali", atje vazhdojnë të jenë përsëri të përpunuar në të gjitha lëndët.

4

Çdo muaj nga kjo shkollë botohet gazeta me emrin simbolik "Bota fëmijore". Aty nxënësit marrin informacion të gjerë. Për shembull, në numrin e fundit, nëntor 2005, flitet për jetën e shqiptarës së madhe Nënë Tereza. Më tej, tregohet rëndësia e shfrytëzimit të librit artistik e shkencor dhe është shpallur lista e Qeverisë së Nxënësve, me president nxënësin e kl.8-A, Besmir Hyseni dhe kryetare nxënësen e kl.8-B, Daniela Masho. Përveç "Faqes letrare", me mjaft vjersha të krijuesve të vegjël, janë botuar fjalë të urta, gazmore, thënje nga njerëz të mëdhenj dhe njohuri për Egjiptin e lashtë.

Tregues i shpirtit krijues të mësuesve e nxënësve janë dhe librat e botuar nga autorë të kësaj shkolle. Kështu, libri i parë në frëngjisht e anglisht titullohet "Bota në paqe", i dyti me vjersha e tregime shqiptare "Bota na thërrret" dhe i treti "Bashkë me detin", që është i nxënësës Flavia Zaka. Me vlera njohëse, sidomos për kolektivin e nxënësve, është monografia "Ali Demi, bir i Çamërisë", shkruar nga mësuesi Mark Ucaj. Sigurisht, edhe këto botime të ndryshme dëshmojnë për jetën e vullstme të kësaj shkolle.

Murat Gecaj

Të reja shkencore

KUR IKIN DRI TAT



Gjatë mungesë së stërgjatur të energjisë elektrike, kohët e fundit kemi mësuar shumë mirë dy gjëra: është e mundur të kalojmë një mbrëmje të tërë në shtëpi pa parë televizor dhe duhet të kemi të gjithë bateri rezervë për celularin.

Për ata që kanë nevojë për një plan më të mirëorganizuar emergjence, ky gjenerator portativ që shihni në foto, i cili ushqehet nga një bateri, siguron kilovatët e nevojshëm të energjisë për tetë orë me një të karikuar të vetme hidrogjeni të padëmshëm për ambientin. AirGen ka masën e një frigoriferi të vogël që mund të futet edhe poshtë një tavoline. Ndryshe nga një gjenerator që punon me lëndë djegëse, ai lëshon vetëm avuj uji dhe nxehtësi, kështu që është i sigurt për t'u përdorur brenda në shtëpi.



PASTRUESI I UJIT

Sipas Kombeve të Bashkuara regjistrohen 6000 vdekje nga uji i ndotur çdo ditë dhe sigurimi i ujit të pastër është problemi më urgjent në botë. Në vijim të përpjekjeve për një zgjidhje, është krijuar një pastrues uji i me kosto të ulët që ka nevojë për pak energji.

Kur po punontë me një gjenerator elektrik vitin e kaluar, shpikësi i kësaj pajisjeje, Din Karmen, vuri re që prodhohej rreth 1000 vat nxehtësi që shkonte dëm. Pajisja e Karmenit përdor nxehtësinë shtesë për të distilluar ujin, për ta zjerë dhe kondensuar atë. Aftësia këtu është përdorimi i sa më pak nxehtësie që të jetë e mundur. Kështu, meqënëse 1000 vat nxehtësi nuk do të ishin të mjaftueshme për të zjerë ujin, Karmen krijoi një sistem të mbyllur që kap nxehtësinë e lëshuar kur del avulli i ujit të zjerë tashmë. Në thelb, ai po

riciklon nxehtësinë. Rezultati është një pajisje që kërkon pak energji, pak shpenzime mirëmbajtjeje, që do të kushtojë 1000 \$ për t'u prodhuar dhe që nxjerr 10 galon ujë të pijshëm në orë.

SKITË E ZGJUARA

Nese po bëni ski, ka shumë mundësi që të jeni me pushime, dhe nëse jeni me pushime, ka shumë mundësi të jeni të lodhur duke menduar. Pse të mos mendoni me këmbë, thjesht sa për të ndryshuar diçka? Skitë e reja iC për kokën janë prodhuar nga një material i veçantë që reagon ndaj stresit fizik duke prodhuar elektricitet. Secila nga skitë iC 300 ka një pajisje kompjuteri që monitoron elektricitetin që prodhohet, si rrjedhim lejon skitë të bëjnë një parashikim të mësuar për



kushtet e borës mbi të cilën ju po bëni ski dhe sa shumë po mundoheni. Më pas, pajisja tejçon këtë sinjal mbrapsht tek skitë, që reagojnë në moment ose duke ngadalësuar ose duke shtuar shpejtësinë. Si rezultat, ju mund t'i kontrolloni më lehtë skitë dhe të bëni një xhiro më të qetë. Ato kushtojnë 750 \$.

TENDA MODERNE

Këto çadra elegante që shihni në foto u përdorën shumë këtë verë nga të rinjtë nëpër koncerte apo zona të tjera turistike, por ato nuk janë thjesht për t'u argëtuar. Të përbërë nga një copë e vetme kartoni të petëzuar (plus një dyshe dhe një derë) ato janë të forta, të mirëizoluara, i rezistojnë erës, nuk depërtohen nga uji dhe nuk kërkojnë aftësi ose mjete të veçanta për t'u montuar. Sipas shpikësit të tyre, ato janë perfekte për t'u



përdorur si streha të përkohshme gjatë një lufte ose fatkeqësie natyrore. Ato janë shumë e përshtatshme për t'u vendosur në lëndina dhe njëra prej tyre kushton rreth 750 \$.

Keshilla praktike

GJASHTË HAPA QË DUHEN NDJEKUR NGA ATA QË KËROJNË PUNË PËR HERË TË PARË

Urime, ia dolët mbanë! Mbaruat universitetin, keni një diplomë në dorë dhe më në fund jeni gati të bëheni të suksesshëm. Tani jeni në botën e vërtetë dhe ka ardhur koha të filloni jetën tuaj profesionale. Nëse jeni në mes të këtij udhëkryqi, mund të jetë gjithçka shumë e frikshme, emocionuese, e turbullt, dërmuese ose të gjitha bashkë. Ja disa hapa për ta bërë një universitet të suksesshëm për tranzicionin e jetës së vërtetë.

HAPI I: PIKETO DREJTIMIN TËNË

Pas katër (apo pesë ose gjashë) vjet universitetit, ju jeni plotësisht të sigurt për atë që doni të bëni, apo jo? Nëse jo, tani është koha të përcaktoni cilat janë pikat tuaja të forta dhe të identifikoni karrierën më të përshtatshme për ju. A ju pëlqen të jeni të rrethuar nga njerëz? Apo preferoni numrat dhe programet e kompjuterit? Konsideroni të gjitha pikat tuaja të forta, dobësitë, preferencat, antipati dhe interesat, kur mendoni për të planifikuar karrierën tuaj. Lexoni për fushat që ju interesojnë dhe flisni me të tjerët që po punojnë me gjera që tërheqin vëmendjen tuaj. Përqëndrohuni në pozicione dhe fusha që përshatën me interesin dhe talentin tuaj.

HAPI II: BËNI KËRKIME

Është thelbësore të mësoni sa më shumë që të jetë e mundur për kompanitë që ju interesojnë dhe konsideroni të gjitha mundësitë tuaja. Pasi të keni identifikuar kompaninë e cila është objektivi juaj, sugjerohet të kërkontë në sitin e internetit të kësaj kompanie, të lexoni artikujt e lajmeve dhe të flisni me punonjësit për të mësuar sa më shumë të mundni. Diçka e rëndësishme për të cilën duhet të interesoheni është qëndrueshmëria e kompanisë, a do të vazhdojë ajo të ekzistojë për një kohë të gjatë?

HAPI III: MBILIDHNI VEGLAT E PUNËS

Është e rëndësishme të keni mjetet e duhura për çdo detyrë. Mjetet e nevojshme për të kërkuar një punë janë një rezymë, një letër me informacione shtesë dhe një dosje e punës suaj. Përpiloni të përpiloni një rezymë dhe letër me informacione shtesë që tregon qartë pikat tuaja të forta dhe eksperiencat tuaja. Në vijim janë disa këshilla që duhet të mbanin mend:

Mendoni për tipin e rezymesë që ju duhet. Një rezymë funksionale që nxjerr në pah aftësitë tuaja në vend të historisë suaj të punës është një zgjedhje e mirë për ata që kërkojnë punë për herë të parë.

Përqëndrohuni tek arritjet dhe rezultatet në vend që të bëni thjesht një përshkrim të eksperiencave.

Përdorni fjalë tërheqëse në rezymenë dhe letrën tuaj me informacione shtesë për të përshkruar eksperiencat tuaja, si përshembull "e filluar", "e realizuar" dhe "e menaxhuar".

Nëse nuk keni shumë eksperiencë pune, shikoni punët me kohë të pjesshme që keni bërë deri atëherë, aktivitetet shkollore ose vendet si vullnetar. Vlerësoni të gjitha eksperiencat tuaja dhe tregoni se si mund të përdoret ajo të cilado punë ju mund të kërkontë.

HAPI IV: RRJETI

Njëra nga detyrat më të rëndësishme gjatë kërkimeve tuaja për punë janë njohjet. Përfiton nga çfarëdo burim që të keni, zyra e punësimit, shokët e diplomuar para jush, shokët e prindërve, ish-profesorë dhe komshinj. Dërgojuni e-maile të njohurve tuaj për t'i pyetur ata nëse mund t'ju ndihmojnë. Dërgoni gjithandaj rezymenë tuaj. Telefononi miqtë tuaj për të parë nëse ata njohin dikë që punon për firmën për të cilën ju jeni të interesuar.

HAPI V: LUANI ROLIN

Nese doni të hyni në botën profesioniste, ju duhet të luani dhe të silleni sipas rolit. Bli një kostum pune dhe visheni atë në të gjitha intervistat. Sigurohuni që adresa juaj e internetit të jetë e përshtatshme. Kjo do të thotë që nëse adresa juaj është "vajzaecmendor2005" ju duhet ta ndryshoni ose të hapni një adresë të re. Mbani mend që të jeni të kujdesshëm edhe në shtëpi. Duhet të jeni të përgatitur për një telefonatë ose një intervistë nga telefoni në çfarëdo orë. Sa më shumë të luani rolin e profesionistit të mirë trajnuar, aq më shumë të tjerët do t'ju shohin si një profesionist.

HAPI VI: MOS U DORËZONI

Bota e vërtetë mund të jetë një sfidë e vërtetë. Jini realist kur shpresoni dhe pranoni që ndoshta do t'ju duhet të filloni nga poshtë për të arritur majat. Ka shumë mundësi që të përballeni me refuzime kur të filloni të kërkontë punën tuaj të parë me orar të plotë, por të gjithë duhet të kalojnë më parë këtu. Mbani mend të jeni aktiv, ngulmues dhe të keni besim që diku ka një vend pune shumë të mirë për ju!

Përgatiti faqen Erica Vangjeli

Tribuna sindikale

